

Vendim nr. 160, datë 20.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Asim Vokshi,	Anëtar

në datën 20.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 25 (A) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket

- KËRKUES:** ALFRED METAJ, përfaqësuar nga avokati Armando Syri, me prokurë të posaçme.
- OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 158, datë 24.06.2021 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2025-1664, datë 14.11.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe kthimi i çështjes për rigjykim.
Shpenzimet gjyqësore në vlerën 75.000 lekë në ngarkim të Ministrisë së Financave.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 15, 18, 27, 28, 29, 30, 33, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 6, 7 e 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë person i shpallur në kërkim nga Interpol Athina, pasi në ngarkim të tij ka pasur një urdhër arresti nga autoritetet e drejtësisë greke. Çështja penale lidhet me një ngjarje kriminale të ndodhur në Greqi në vitin 2002, ku ka qenë i përfshirë kërkuesi në bashkëpunim me persona të tjerë. Kërkuesi së bashku me dy shtetas të tjerë shqiptarë kanë kryer vjedhje në banesën e një shtetasi gjerman. Të tre autorët kanë ushtruar dhunë të rëndë fizike (grushte dhe goditje), duke i shkaktuar shtetasit gjerman humbjen e jetës. Sipas autoriteteve greke, në këmbën e karriges, që ka shërbyer për të goditur viktimën, janë gjendur gjurmët e gishtërinjve të kërkuesit.

2. Në datën 04.04.2016, mbi bazën e materialit të dërguar nga Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat ka regjistruar procedimin penal nr. 227 të vitit 2016, mes të tjerëve, edhe në emër të kërkuesit për veprat penale “Vjedhja me dhunë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 139 dhe 25 të Kodit Penal (KP) dhe “Vjedhja me pasojë vdekjen”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 141 dhe 25 të KP-së.

3. Gjatë gjykimit në shkallë të parë kërkuesi ka kërkuar të gjykohet me gjykim të shkurtuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar se pavarësisht se çështja është dërguar për gjykim përpara se të hynin në fuqi ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale (KPP) të vitit 2017, të cilat ndalojnë gjykimin e shkurtuar për veprat penale që parashikojnë dënimin me burgim të përjetshëm, duhet të zbatohet kjo dispozitë, pasi kërkesa për gjykim të shkurtuar është paraqitur pas ndryshimeve ligjore.

4. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 197, datë 06.06.2019, ka vendosur për kërkuesin: i) deklarinin fajtor për veprën penale “Vjedhja me pasojë vdekjen”, të kryer në bashkëpunim dhe dënimin e tij me 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim (vuajtja e dënimit fillon në datën 14.04.2016, që është data e arrestimit të tij në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat nr. 9, datë 14.04.2016 dhe kryhet në burg të sigurisë së zakonshme) ; ii) deklarinin të pafajshëm të kërkuesit për veprën penale “Vjedhja me dhunë”, të kryer në bashkëpunim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka arsyetuar se fajësia për kryerjen e veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen është bazuar në tërësinë e provave, shenjat daktiloskopike, pyetjen e dëshmitarëve dhe deklarinimet e marra nëpërmjet letërporosive nga autoritetet greke.

5. Kërkuesi ka paraqitur ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit për pafajësinë dhe uljen me 1/3-ën e dënimit, duke u deklaruar fajtor për veprën penale të plagosjes me pasojë vdekjen dhe jo të vjedhjes me pasojë vdekjen. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 158, datë 24.06.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtën linjë arsyetimi për sa i përket themelit të çështjes. Për kërkesën për t'u gjykuar me gjykim të shkurtuar, gjykata e apelit ka arsyetuar, ndër të tjera, se rrëzimi i saj është i drejtë, për shkak se mbrojtja dhe i pandehuri nuk i kishin pranuar faktet dhe provat ashtu siç ishin paraqitur në kërkesën për gjykim, por kishin pretendime për ngjarjen, akuzën dhe faktin penal, çka e bënte të domosdoshëm gjykimin e zakonshëm që provat t'i nënshtroheshin debatit gjyqësor. Kërkuesi ka ushtruar rekurs ndaj vendimit të gjykatës së apelit.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1664, datë 14.11.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk ishin parashtruar shkaqe të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, të tilla që të cenonin vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Vlorë. Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje kërimit kryesor për kërkesën për gjykimin e shkurtuar, duke arsyetuar se pavarësisht argumentit të gjykatave të faktit për zbatimin e ndalimit ligjor të parashikuar në nenin 403, pika 2, të KPP-së (në fuqi), për të cilin Kolegji vlerëson se nuk gjen zbatim, gjykata e apelit ka arsyetuar se edhe nëse do të përmbushej kushti substancial për zbatimin e gjyimit të shkurtuar, kërkesa nuk do të pranohej për faktin se vetë pretendimet e ngritura nga mbrojtja e bënin të domosdoshëm gjykimin e zakonshëm, me qëllim që provat t'i nënshtroheshin debatit gjyqësor. Në këtë kontekst, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se në këtë gjykim janë marrë prova me letërporosi nga jashtë shtetit, janë pyetur dëshmitarë, si dhe vetë i gjykuari, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se marrja dhe dëgjimi i këtyre provave ka diktuar nevojën e debatit gjyqësor, pasi çështja nuk mund të zgjidhej mbi bazën e akteve të hetimeve paraprake. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit, pavarësisht se ka ndarë të njëjtin qëndrim me gjykatën e shkallës së parë lidhur me kushtin formal për pranimin e gjyimit të shkurtuar, e ka kontrolluar në mënyrë efektive dhe në substancë vendimin për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, duke dhënë një arsyetim të plotë dhe shterues në këtë drejtim.

7. Kërkuesi në datën 25.03.2026 nëpërmjet shërbimit postar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procesi gjyqësor është cenuar:

8.1. *Parimi i sigurisë juridike i lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë devijuar nga praktika gjyqësore, duke cenuar parimin e sigurisë juridike dhe trajtimin e barabartë. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në shqyrtimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar nuk kanë pasur parasysh përfundimet e përcaktuara me vendimin njësuës nr. 00-2024-2161 (167) datë 04.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për zbatimin e nenit 403, pika 2, të KPP-së për rastet kur gjykatat në përfundim të gjykimit të zakonshëm i japin faktit një cilësim tjetër juridik për një vepër penale që nuk parashikon dënimin me burgim të përjetshëm. Në rastin konkret, vendimet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë nuk kanë të njëjtën linjë arsyetimi si vendimi njësuës.

8.2. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor i lidhur me parimin e mosdënimit pa ligj*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë dhënë vendime me arsyetim jologjik. Kërkuesi, edhe gjatë gjykimit të zakonshëm, nuk ka kërkuar pavlefshmërinë ose papërdorshmërinë e provave. Gabimi ligjor e logjik i dy gjykatave të faktit nuk është korrigjuar as nga Gjykata e Lartë. Zgjedhja e gjykimit të shkurtuar ndikon drejtpërdrejt në masën e dënimit, për rrjedhojë ndikon edhe në parimin e mosdënimit pa ligj.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës

janë të natyrës kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e çështjes në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, por vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre.

11. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson të ndalet në analizën e legjitimitetit *ratione materiae*, në drejtim të të cilit kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të sigurisë juridike të lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit*, si dhe të *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e mosdënimit pa ligj*, duke parashtruar në thelb se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk e kanë pranuar kërkesën për t'u gjykuar me gjykim të shkurtuar në kundërshtim me ligjin.

12. Kolegji vlerëson se pretendimet në thelb lidhen me vendimmarrjen/qëndrimin e mbajtur nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrëzimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar, ndaj do të trajtohen në aspekt të së *drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, të garantuar nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës.

13. Lidhur me të drejtën e aksesit, Gjykata ka theksuar se nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse ajo, para së gjithash, është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimin nr. 31, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në drejtim të së drejtës për proces të rregullt, në jurisprudencën kushtetuese është evidentuar se ajo përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë që ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Sipas Gjykatës, detyrë e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht i tillë që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur

gjetjet e tyre mund të konsiderohen si të marra nga një gjykatë thelbësisht e pakujdesshme. Thënë ndryshe, ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyt në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në kuptim të standardeve të mësipërme dhe referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore të dhëna në çështjen e kërkuarit, Kolegji vlerëson se ato tregojnë mjaftueshëm rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra prej tyre, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ato janë bazuar në zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë. Gjykatat e faktit kanë arsyetuar për rrëzimin e kërkesës procedurale të kërkuarit për t'u gjykuar me gjykim të shkurtuar, e cila, sidomos sipas arsytimit të plotësuar të gjykatës së apelit, nuk është pranuar, ndër të tjera, për shkak se çështja nuk mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet, por nevojitej marrja e provave në seancë gjyqësore, çka edhe është bërë. Nisur nga kjo, gjykatat e faktit që kanë deklaruar fajtor dhe dënuar kërkuarin, rezulton se kanë përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimeve, ndërkohë që interpretimi i ligjit prej tyre, i shprehur përmes arsytimit të vendimit, nuk duket të jetë i paarsyeshëm, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

17. Edhe për sa i përket vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i marrë në dhomën e këshillimit në funksion të shqyrtimit paraprak të rekursit, ai tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe në pjesën arsyetuese, argumentet ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, sikundër edhe arsytimit të kufizuar për to, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuari është haptazi i pabazuar, si dhe i ka dhënë përgjigje të shprehur edhe pretendimit për refuzimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar nga gjykatat më të ulëta (*shih paragrafin 6 të vendimit*). Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se, ndryshe nga sa pretendon kërkuari, vetëm refuzimi i kërkesës për t'u gjykuar me gjykim të shkurtuar, kur nevojitej marrja e provave në seancë për shkak të qëndrimit të kësaj pale në lidhje me faktet, nuk sjell automatikisht cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe se zhvillimi i gjykimit të zakonshëm ka garantuar një shqyrtim më të plotë të fakteve, në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar. Për sa i përket kërkesës së kërkuarit për shpenzimet gjyqësore, evidentohet se, sipas nenit 28 të Ligjit Organik të Gjykatës, ajo shqyrtohet kur Gjykata vendos pranimin e ankimit kushtetues

individual. Për sa kohë çështja nuk i plotëson kriteret për kalimin për shqyrtim në seancë plenare, në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes, kjo kërkesë nuk mund të merret në shqyrtim.

18. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare, pasi është haptazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.